

A JANË INSTITUCIONET SHTETËRORE SHQIPTARE TË PËRGATITURA PËR HAPJEN E NEGOCIATAVE?

*Rëndësia e procesit të transparencës,
pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit me
shoqërinë civile.*

EU Policy Hub

Informacioni paraprak

Shqipëria e ka nisur rrugëtimin e saj në procesin e integritimit evropian nga viti [1991](#) kur vendosi marrëdhëniet diplomatike me Komunitetin Evropian dhe rreth 9 vite më vonë u njoh zyrtarisht nga [Bashkimi Evropian](#) (BE), si një vend kandidat potencial. Prej vitit [2000](#) e deri më sot Shqipëria është përfshirë në një proces të gjatë reformimi për përparimin në procesin e integritimit evropian dhe aderimin në BE duke përfaqësuar vullnetin dhe dëshirën më të madhe të popullit shqiptar. Procesi i integritimit evropian ka shtyrë përpara reforma të cilat kanë sjellë përafrimin e legjislativimit shqiptar me Acquis e BE-së, ngritjen e strukturave shtetërore në kuadër të avancimit të procesit dhe përmbushjes së detyrimeve duke përmirësuar performancën e institucioneve publike në ofrimin e shërbimeve dhe arritjen e disa prej standardeve të BE-së. Më 26 mars 2020, [Këshilli Evropian](#) miratoi vendimin për hapjen e negociatave me Shqipërinë. Megjithatë nga një [vlerësim](#) i krahasuar midis Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, vërehet një kohëzgjatje e madhe e marrë nga Shqipëria për të kaluar etapat nga momenti i nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) deri në fazën e hapjes së negociatave. Ndërkohë që Kroacisë ju deshën 3 vite, Malit të Zi 5 vite, Serbisë 6 vite, Shqipëria ka nënshkruar MSA në 2006 dhe akoma është në pritje të fillimit të negociatave. Pa përfshirë Maqedoninë e Veriut e cila për arsye të tjera morri 19 vite për të hapur negociatat. Ky dokument analitik ka për qëllim të paraqesë një analizë mbi përgatitjen e institucioneve shtetërore për hapjen e negociatave, struktura e ngritura dhe përfshirjen e shoqërisë

civile në to. Argumentin ynë kryesor është që për të pasur një proces më llogaridhënës, transparent dhe gjithëpërfshirës me negociatat dhe për të pasur një kontribut real në procesin më të rëndësishëm strategjik dhe transformues për vendin dhe për interesat e qytetarëve, ka nevojë për një përfshirje reale, konkrete dhe konstruktive të të gjithë aktorëve, duke përfshirë Parlamentin, bashkitë, shoqatat e biznesit, botën akademike, grupet e interesit, OJF-të, ekspertët, dhe aktorë të tjerë.

Legjislativimi

Krijimi i një mjedisi mundësues për organizatat e shoqërisë civile është një nga parakushtet dhe masat për një demokraci të qëndrueshme në një shtet modern. Udhërrëfyeni fillestar për një politikë mundësuese të qeverisë për zhvillimin e shoqërisë civile u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 459, datë 27.5.2015. Një dokument i rishikuar i Udhërrëfyesit u miratua me [VKM Nr. 539¹](#), i cili identifikon tre fusha strategjike me një paketë prej 42 masash që duhet të ndërmerren nga institucionet e përcaktuara dhe 130 tregues për monitorimin e tyre. Nga faqja e [Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile](#) (AMSHC) nuk rezulton asnjë raport për vlerësimin e përmbushjes së masave të parashikuara në Udhërrëfyeni.

Avancimi në procesin e integritimit evropian dhe marrja e vendimit nga BE për hapjen e negociatave me Shqipërinë, kërkuar marrjen e masave nga qeveria shqiptare për ngritjen e strukturës përgjegjëse për zhvillimin e negociatave. [VKM Nr. 749²](#) bëri të mundur ngritjen e strukturës

1. VKM Nr. 539, datë 25.07.2019 "Për miratimin e udhërrëfyesit për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019-2023".
2. VKM Nr. 749, datë 19.12.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian".

përgjegjëse për zhvillimin e negociatave, e cila në përbërje të saj ka: Komitetin Shtetëror për Integrimin Evropian; Delegacionin Shtetëror; Grupin negociator; Misionin e Shqipërisë në BE; Sekretariatit e Integritimit Evropian; grupet ndërinstitucionale të punës; Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE). Në kuadër të sa më sipër, [Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme](#) (MEPJ) ka ngritur [nënfaqen e internetit](#) në të cilën mund të gjeni të pasqyruar në mënyrë përshkruese rrugëtimin e Shqipërisë në procesin e integritimit evropian, procesin e negociatave dhe strukturën përgjegjëse për zhvillimin e negociatave, nënstrukturat përbërëse të saj, etj. Në kreun IX të vendimit të sipërpërmendur është përcaktuar ngritja e PPIE, platforma e cila do të bëjë të mundur informimin, konsultimin dhe komunikimin në procesin e negociatave për anëtarësimin në BE të aktorëve të shoqërisë civile si grupet e interesit, organet e njësive të qeverisjes vendore, sindikatat, botën akademike etj. Me [Urdhrin e Kryeministrit Nr.113](#)³ u bë organizimi dhe funksionimi i strukturës institucionale të Platformës, ku kjo e fundit ka për detyrë:

- Të rrisë ndërgjegjësimin e publikut në procesin e anëtarësimit në BE;
- Të shpjegojë ndikimin e procesit të anëtarësimit për vendin dhe shoqërinë;
- Të informojë mbi procesin e negociatave dhe procesin e bërë për çdo fazë, duke krijuar mundësi për përthithjen e ekspertizës vendase në fushat përkatëse;
- Të mbështesë një përfaqësim gjithëpërfshirës të të gjithë partnerëve, publikë dhe privatë, në procesin e stabilizim-asociimit dhe anëtarësimit të Shqipërisë në BE;
- Të mundësojë aksesin e shoqërisë civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, të shoqatave të punëmarrësve, të botës akademike dhe të grupeve të interesit për këshillimin e monitorimin në fazat e programimit e zbatimit të asistencës së Bashkimit Evropian për procesin e integritimit evropian.

PPIE funksionon me dy nivele përfaqësimi:

- Bordi drejtues, që drejton PPIE dhe kryesohet nga Kryeministri dhe Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme. Në përbërje të tij janë 15 anëtarë: Zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme; Kryenegociatori; Drejtuesi i Sekretariatit të Integritimit Evropian; Drejtori përgjegjës për bashkëpunimin territorial për

zbatimin e projekteve IPA; Drejtori përgjegjës për koordinimin e programeve kombëtare e rajonale të IPA-s; Dy përfaqësues të shoqatave të organeve të pushtetit vendor; Dy përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile; Dy përfaqësues të komunitetit të biznesit; Dy përfaqësues të shoqatave të punëmarrësve; Dy përfaqësues të botës akademike.

- 33 tryeza të diskutimit dhe të këshillimit, të cilat krijohen në mënyrë analoge me kapitujt e Acquis të BE-së.

Çdo anëtar i shoqërisë civile për të qenë pjesë e tryezave të diskutimit dhe këshillimit duhet të dorëzojë një letër interesi, si dhe CV të personit apo të grupimit që përfaqëson, ku tregohet se ka ekspertizën apo interesin e mjaftueshëm për të kontribuar në tryezën/at specifike. Pranimi apo refuzimi i aplikimeve bëhet nga grupet ndërinstitucionale të punës. Përfaqësimi i tryezave në Bordin Drejtues bëhet përmes zgjedhjes nga të gjithë anëtarët e tryezave të ngritura të dy përfaqësuesve për secilën prej kategorive të përcaktuara më sipër si anëtarë të shoqërisë civile.

Përballja me realitetin

Organizimi i PPIE me dy nivele përfaqësimi është një mundësi e mirë për të gjithë përfaqësuesit e grupeve të ndryshme të shoqërisë civile për të marrë pjesë në procesin e negociatave të Shqipërisë dhe për të dhënë ekspertizën apo eksperiencën e tyre në fusha të caktuara që përfshihen në procesin e negociatave. Të dy nivelet e përfaqësimit janë të lidhura fort me njëra tjetrën për funksionimin e PPIE. Tryezat e diskutimit dhe këshillimit kryesohen nga grupet ndërinstitucionale të punës (tashmë të ngritura, por të papublikuara në faqet zyrtare) dhe koordinohen nga ministritë dhe institucionet përgjegjëse për secilin kapitull të acquis-it të BE-së. Diskutimet dhe rekomandimet e nxjerra prej tyre i drejtohen Bordit Drejtues, i cili merr në konsideratë apo vlerëson opinionet, e qëndrimet dhe ekspertizën e tyre për procesin e integritimit evropian. Krijimi i 33 tryezave të diskutimit dhe këshillimit është një domosdoshmëri dhe nevojë për funksionimin e PPIE. Mos ngritja e tryezave, sjellë mosfunksionimin e Bordi Drejtues dhe të vetë PPIE-së dhe në lidhje me PPIE, ministritë luajnë një rol të rëndësishëm, si në ngritjen dhe koordinimin e punës së 33 tryezave të diskutimit dhe këshillimit.

3. Urdhri i Kryeministrit Nr.113, datë 30.08.2019 "Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian"

Nga raportimi i KM pranë Kuvendit të Shqipërisë mbi [‘Ecurinë e procesit të integritimit për vitin 2019’](#) edhe pse ngritja e PPIE është miratuar në gusht të vitit 2019, ngritja e saj është bërë e mundur vetëm në dhjetor të vitit 2019. Po sipas raporteve, parashtrahet se është ngritur tryeza e PPIE për Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore, me vendim të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Kapitullin 23. Për Kapitullin 22 – Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore, janë paraqitur 10 aplikime nga shoqëria civile për të qenë pjesë e tryezës për këtë kapitull dhe përbërja e tryezës është gati për miratim në mbledhjen e ardhshme të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Kapitullin 22. Ndërkohë raportohet se vazhdon procesi i aplikimeve për ngritjen e tryezave të partneritetit edhe për kapitujt e tjerë negociues. Vlen për t’u theksuar fakti se në [nënfaqen e internetit](#) e ngritur nga MEPJ nuk ka asnjë informacion për përfaqësuesit e shoqërisë civile të përzgjedhur për të qenë pjesë e tryezave të diskutimit dhe këshillimit për Kapitullin [22](#) dhe [23](#) (tashmë të ngritura).

Legjislacioni në fuqi kërkon që informacioni duhet të merret gjerësisht nga faqet zyrtare të ministrive, por nga këto të fundit konstatohet se vetëm [Ministria e Turizmit dhe Mjedisit](#), [Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale](#), [Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë](#) [këtu](#) dhe [këtu](#) kanë informuar vetëm në lidhje me organizimin e një takimi në kuadër të PPIE-së, që në fokus ka pasur prezantimin e PPIE-së dhe hapjen e aplikimeve për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në tryezat e diskutimit dhe këshillimit. Në lidhje me ecurinë e takimit, vijimësinë e takimeve të kryera dhe përzgjedhjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile nuk paraqitet asnjë informacion. Nga ana tjetër, vihet re që asnjë prej faqeve zyrtare të ministrive nuk ka një rubrikë të dedikuar për procesin e negociatave, kapitujt që do të koordinohen prej saj, grupet ndërinstitucionale të punës të ngritur, aktivitetet e procedurat e ndërmarra dhe informacionin mbi PPIE.

Në [18 Qershor 2020](#) u prezantua Z. Zef Mazi si Kryenegociatori për Zhvillimin e Negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Një lajm i shumëpritur dhe i vlerësuar për të çuar përpara procesin e negociatave. [VKM Nr. 422](#), datë 6.5.2020⁴ përcakton rregullat e funksionimit dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave duke paraqitur një sërë sfidash për

modelin e përzgjedhur shqiptar:

- Kabineti i Kryenegociatorit funksionon pranë Kryeministrit dhe Kryenegociatori barazohet me titullin e Ministrit të Shtetit që ka të drejtë të ketë një ekip prej 5 këshilltarësh. Ekipi paraqet vështirësi si në numrin e ulët por edhe me vlerësimin financiar të tyre duke pasur parasysh ngarkesën e lartë dhe rëndësinë që do të ketë kjo detyrë.
- Kabineti i Kryenegociatorit duhet të bashkëpunojë me njësinë përgjegjëse për nismat ligjore prioritare dhe acquis në Kryeministri. Kjo njësi është krijuar e re dhe ka nevojë të tërheqë dhe përzgjedhë specialistë me eksperiencë për të përmbushur sfidat e procesit.
- Kryenegociatori mbështetet nga [Sekretariati i Integritimit Evropian](#) (SIE) që përbëhet nga nëpunës diplomatikë dhe civilë të ministrisë përgjegjëse për çështjet e integritimit evropian dhe punët e jashtme. SIE duhet të ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për integrimin evropian për funksionimin e SIE për të cilin deri tani nuk ka informacion nëse është krijuar dhe cila është përbërja nominale.
- SIE është i bazuar në MEPJ dhe kjo e vështirëson bashkëpunimin, pasi SIE duhet ti sigurojë Kryenegociatorit ndihmën e duhur teknike dhe asistencën administrative për të mbështetur zbatimin e detyrave të tij.
- Kryenegociatori, ndryshe nga gjithë vendet e rajonit siç mund të konsultohet [këtu](#), është caktuar të jetë edhe Koordinatori Kombëtar për Instrumentin e Paraaderimit të asistencës financiare të BE (NIPAC) dhe siguron pjesëmarrjen e anëtarëve të Grupit Negociator në programimin dhe monitorimin e asistencës financiare të BE-së në kapitujt që janë përgjegjës. Detyra e NIPAC jo vetëm që është një detyrë e vështirë dhe me ngarkesë, por ka nevojë për mbështetje nga Departamenti i IPA në MEPJ dhe bashkëpunimi me të gjitha ministrinë.
- [VKM Nr.421](#), datë 27.05.2020⁵, përcakton modalitetet financiare për shpërblimin e punës për anëtarët dhe subjektet jo anëtare të grupit negociator. Për të tërhequr dhe mbajtur specialistë të aftë dhe për të pasur një performancë sa më të mirë të ekipit negociator dhe strukturave të tjera mbështetëse ka nevojë për përzgjedhjen e politikave financiare të stimuluese krahasuar me tregun e punës jashtë administratës publike.

4. Urdhri i Kryeministrit Nr.113, datë 30.08.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian”

5. VKM Nr.421, datë 27.05.2020, ‘Për shpërblimin e punës për anëtarët dhe subjektet joanëtare të grupit negociator për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, si dhe të funksionarëve të kabinetit të Kryenegociatorit’.

Konkluzione dhe rekomandime

- Shqipëria ka bërë të mundur deri tani të krijojë një kornizë zyrtare bashkëpunimi qeveri-shoqëri civile, falë edhe presionit nga BE. Megjithatë krijimi i këtyre mekanizmave të bashkëpunimit nuk ka bërë të mundur përkthimin e mjaftueshëm të tyre në praktikë. Këtu mund të përmendim ngritjen e këshillave konsultuese si [Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile](#) (KKSHC) dhe [Këshilli Kombëtar për Integrimin Europian](#) (KKIE) të cilat nuk kanë arritur të përmbushin në nivelin e duhur detyrat e tyre në përfshirjen dhe konsultimin e shoqërisë civile në procesin e integritimit. Përveç rishikimit të rolit dhe funksionimit të KKSHC dhe KKIE, mund të shikohet mundësia e ngritjes pranë MEPJ të një sektori direkt përgjegjës për koordinimin e punës me shoqërinë civile. Nga ana tjetër OSHC kanë nevojë të rrisin besimin dhe bashkëpunimi midis tyre në mënyrë që të flasin të bashkuar dhe me një zë për çështjet që ngrenë.
- Procesi i konsultimit publik shpesh zhvillohet mbi baza ad-hoc, me [pjesëmarrje të ulët të shoqërisë civile](#), dhe në rastin kur jepen rekomandime, ato nuk pasqyrohen në versionet përfundimtare të dokumenteve duke prodhuar një proces konsultimi të realizuar më tepër në një mënyrë pro forma, vetëm sepse kërkohet nga BE.
- Hapësira për shoqërinë civile në procesin e integritimit në BE nuk është e mjaftueshme dhe duhet të zgjerohet dhe ky ndryshim drejt përfshirjes kuptimplotë kërkon përpjekje të mirëfillta nga të dy palët, qeveria dhe sektori i shoqërisë civile. Qeveria duhet të pranojë rolin që OSHC-të luajnë si një urë midis administratës dhe qytetarëve, duke u dhënë organeve politike njohuri dhe rekomandime se si të krijojnë politikat e duhura. Shoqëria civile duhet të angazhohet në mënyrë proaktive për të kontribuar në përgatitjen e akteve ligjore dhe politikave cilësore që kontribuojnë më shumë në mirëqenien e qytetarëve.
- Vendimi për hapjen e negociatave për Shqipërinë erdhi në një moment kur Shqipëria ishte në gjendjen e karantinimit, si rezultat i pandemisë së shkaktuar nga COVID-19. Ministritë, pavarësisht përpjekjeve të tyre në kushte më të vështira pune, nuk kanë pasqyruar informacionin, dokumentacionin apo mekanizmat në dispozicion të shoqërisë civile për përfshirjen në këtë proces. Mungesa e informacionit ka sjellë mosaktivizimin dhe mospjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin e negociatave dhe tek ky proces ka nevojë fokusohet veprimtaria e ministrive në të ardhmen.
- Komunikimi i procesit të integritimit dhe procesin e vështirë të negociatave dhe kjo është një nga detyrat më të rëndësishme për institucionet publike, për të cilin kanë nevojë të bashkëpunojnë me shoqërinë civile. Aktualisht ka nevojë për hartimin e një strategjie komunikimi nga MEPJ e koordinuar me institucionet e tjera publike për të mundur që procesi i komunikimit të mos kryet më i copëzuar midis projekteve të ndryshme nga donatorë të ndryshëm pa arritur rezultatet që mund të sillte koordinimi i tyre. MEPJ mund ta vlerësonte si një mundësi e mirë ku vetë shoqëria civile mund të jepte kontributin e saj duke koordinuar projektet që ato zbatojnë në fushën e integritimit europian.
- Administrata duhet të krijojë lidhje të forta me qytetarët dhe shoqërinë civile për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e reformave dhe për të siguruar njohuri në proceset e integritimit dhe përfshirjen e tyre. MEPJ duhet të paraqesi të gjithë informacionin në lidhje me strukturën përgjegjëse për zhvillimin e negociatave, duke përfshirë anëtarët përgjegjës në çdo strukturë të ngritur, punën e kryer deri më sot, mbledhjet e organizuara dhe çdo dokumentacion apo procedurë të ndjekur. Ministritë duhet të paraqesin të gjithë informacionin dhe dokumentacionin në lidhje me procedurat e ndjekura, personat e përzgjedhur në strukturat përkatëse, dokumentet e miratuar. Ministritë duhet të parashikojnë në faqet e tyre zyrtare një rubrikë të veçantë dedikuar procesit të negociatave dhe ecurinë e tyre.
- Nëse do të shikonim eksperiencën e vendeve të rajonit, si Serbia dhe Mali i Zi që tashmë e kanë kaluar fazën në të cilën ndodhet Shqipëria, do të vinim re se jo vetëm që institucionet shtetërore kanë pasqyruar informacionin dhe dokumentacionet e ardhur si rezultat i procesit të hapjes së negociatave, por vihet re një rol shumë thelbësor i shoqërisë civile në këtë proces. Në Malin e Zi, roli i shoqërisë civile është shumë i fortë në procesin e negociatave për vetë faktin se përfaqësues të saj janë pjesë e grupeve qeveritare negociatore. Po në Malin e Zi, 30% të Strukturës Shtetërore Negociatore e përbëjnë përfaqësuesit e shoqërisë civile. Nga ana tjetër në Serbi përveç ekzistencës së platformës (Konventa Kombëtare e Bashkimit Evropian) për përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e

negociatave ekzistojnë platforma tematike të ngritura nga shoqëria civile, si “[prEUgovor](#)” që monitoron Kapitujt 23 dhe 24 apo “[Coalition 27](#)” që monitoron Kapitullin 27 për Mjedisin dhe ndryshimet klimaterike.

- Edhe pse procesi i negociatave do të zgjasë në kohë, ngritja e strukturave sa më shpejtë dhe fillimi i punës prej tyre, do të përbënte hap para në procesin e negociatave dhe do të krijonte baza të forta për një proces të mirëstrukturuar dhe mirëstudiuar. Ngritja e strukturave vetëm atëherë kur përfundojnë afatet apo në momentin e fundit për të mos shkelur afatet ligjore sjellë procedura dhe struktura problematike, të cilat nuk arrijnë të shprehin zërin e shoqërisë civile dhe nuk lejojnë pjesëmarrjen efektive të saj në procesin e hapjes së negociatave. Eksperiencat e vendeve që e kanë kaluar këtë fazë duhet të merren në konsideratë nga institucionet shqiptare për të përmirësuar strukturat dhe procedurat aktuale dhe për të mos bërë gabimet.
- Administrata publike duhet të zbatoj parimet e BE-së për administratën publike pasi ato kanë treguar të jenë të domosdoshme. BE duhet të mendojë të fuqizojë më tej zbatimin e parimeve të administratës publike dhe të ashpërsojë masat për moszbatimin e tyre. Shqipëria ka nevojë të hartojë një strategji kombëtare për aderimin në BE sipas shembujve të vendeve të tjera si [Serbia](#) që e ka përgatitur prej vitit 2005 dhe rishikuar më pas me [dokumentet](#) e tjera. Ky dokument do të shërbejë jo vetëm për të vlerësuar kapacitetet, boshllëqet, por edhe për të analizuar nevojat dhe përcaktuar kontributin që mund të japin si institucionet publike por dhe të gjithë aktorët jashtë saj. Raporti i përgatitur nga Këshilli i Ministrave për Kuvendin mbi ‘Planifikimin e burimeve njerëzore dhe financiare në mbështetje të procesit të bisedimeve për anëtarësimin në Bashkimin Evropian’ nuk është konsultuar me shoqërinë civile dhe nuk parashikon angazhimin e saj në procesin e negociatave. [Plani Kombëtar Për Integrimin Evropian \(PKIE\) 2020 – 2022](#) përcakton detyrimet që kanë institucionet publike në çdo kapitull, pa përcaktuar mundësitë e angazhimit dhe kontributit nga shoqëria civile.
- Në *hartimin* e [PKIE 2020 – 2022](#), aktorët jo shtetërorë u ftuan nga MEPJ të marrin pjesë në një takim konsultimi mbi të cilin nuk ekziston informacion mbi pjesëmarrjen. Për sa i përket *miratimit*, MPEJ nuk ka vendosur në faqen e

internetit variantin e miratuar në [19 Shkurt 2020](#). Mbi *monitorimin* e zbatimit të PKIE nuk ka informacion të disponueshëm për publikun. Përveç disa nismave nga [Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë](#) (OSFA) për [Monitorimin e zbatimit të MSA](#) dhe më pas [PKIE](#) nuk ka informacion mbi përmbushjen e angazhimeve të paraqitura në PKIE. MPEJ, pavarësisht punës të bërë për krijimin e [nënfaqes së internetit](#), dokumentet e monitorimit nuk janë të publikuara. Ndryshe nga eksperiencia e viteve të mëparshme kur mbas këmbënguljes të shoqërisë civile u arrit që ish-Ministria e Integritimit Evropian publikoi raportet e monitorimit në faqen zyrtare. Dokumentit voluminoz i PKIE, organizimi i një procesi jo proaktiv konsultimi i PKIE ka prodhuar një proces të cunguar konsultimi i cili duhet të jetë në fokus në të ardhmen për tu përmirësuar.

- Ndryshe nga raundet e mëparshme të zgjerimit të BE, ai me Shqipërinë do të kryhet sipas metodologjisë së re. Procesi i pranimit do të organizohet në fusha tematike që grupojnë kapitujt e mëparshëm. Roli i Parlamentit do të jetë thelbësor në mënyrë që reformat kryesore të miratohen dhe zbatohen me sukses por edhe për të siguruar mbështetje politike nga të gjitha partitë, si dhe për të mbikëqyrur zbatimin e tyre. Roli i Kuvendit në procesin e integritimit rregullohet me [Ligjin Nr.15/2015](#)⁶, ndërkohë që [VKM Nr. 749](#) për organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse për zhvillimin e negociatave parashikon një rol të kufizuar të Kuvendit duke bërë të nevojshme rishikimin e tyre.
- Kryerja e një hartëzimi dhe modaliteteve për përfshirjen e përfaqësuesve nga bota akademike, shoqëria civile, shoqatat e biznesit, ekspertë dhe aktorë të tjerë në procesin e negociatave. MEPJ ka organizuar një ftesë për aplikime nga ekspertë, por ka nevojë që të organizohet një proces i strukturuar ku ekspertët dhe aktorët e tjerë të shoqërisë civile të ftohen të aplikojmë dhe listohen sipas ekspertizës që kanë në çdo kapitull të acquis.
- Nën drejtimin e MEPJ mund të mundësohet krijimi i një grupi sektorial pune për një koordinim më të mirë të punës dhe projekteve donatorët që mbështesin procesin e integritimit evropian. Kjo do të ishte e rëndësishme jo vetëm për të shmangur mbivendosjet, përmirësuar koordinimin, transparencën dhe komunikimin, por edhe për siguruar burimet e nevojshme financiare dhe sigurimin e asistencës teknike në mbështetje të negociatave të anëtarësimit.

6. [Ligjin Nr.15/2015](#) Për rolin e Kuvendit në procesin e integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.